



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:210133

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05543356

2023:210134

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në çështjen juridiko - kontestimore të paditëses Z. Sh. nga nga Kaçaniku, e identifikuar me numër personal ..., R. Sh. nga Kaçaniku, e identifikuar me numër personal ..., të cilat me autorizim e përfaqëson M. K. B. avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurve H. Sh. nga Ferizaj, S. Gj. nga Kaçaniku, K. Zh. nga Kaçaniku, D. Sh. nga Kaçaniku, F. Sh. nga Ferizaj, E. Sh. nga Kaçaniku, Dh. Sh. nga Ferizaj, R. Sh 1. nga Kaçaniku dhe R. Sh. 2 nga Kaçaniku, në çështjen kontestuese vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me datë 03.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

(Në bazë të pohimit)

**I. APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Z. Sh. dhe R. Sh. nga Kaçaniku, në tërësi si e bazuar dhe **VËRTETOHET** se:

**I.a)** Paditësja Z. Sh. nga Kaçaniku, e identifikuar me letërnjoftim me numër personal: ..., është pronare legjitime e paluajtshmerise edhe atë Pk.nr. ..., në vendin e quajtur “O..”, me sipërfaqe prej 00.00.70 ha, e cila gjendet në Z.K. Kaçanik, e evidentuar sipas certifikatës pronësore me nr. ... emër të të ndjerit E. F. Sh.

**I.b)** Paditësja R. Sh. nga Kaçaniku, e identifikuar me numër personal ..., është pronare legjitime e paluajtshmerise edhe atë Pk.nr. ..., në vendin e quajtur “O...”, me sipërfaqe prej 00.01.59 ha, e cila gjendet në Z.K. Kaçanik, e evidentuar sipas certifikatës pronësore me nr. ... emër të të ndjerit E. F. Sh..

**II. DETYROHEN**, të paditurit që paditësve të ja njohin të drejtën e pronësisë për pjesën e shënuar në pikën –I- të këtij dispozitivi dhe t’ia lejojnë paditësve që të realizojë të drejtën pronësore, e tëra kjo në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**III.** Ky Aktgjykim ka titull përmbartimorë dhe shërben si bazë juridike për regjistrimin e paluajtshmërive në Regjistrin e të Drejtave Pronësore, ndërsa shpenzimet e procedurës i përballon secila palë dhe Gjykata konstaton se pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore për padi në lartësi prej 20€.

### A r s y e t i m

Paditëset me datë 04.10.2023, përmes së autorizuarës së tyre, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ka theksuar se paditëset janë poseduese faktike të paluajtshmerive, të cilat evidentohen në emër të paraardhësit të të paditurve, sipas certifikatës pronësore me nr. ..., në emër të të ndjerit E. F. Sh., e që procedura e shqyrtimit të trashëgimisë nga ana e pasardhësve (të paditurve) nuk është kryer deri më tani dhe nuk kanë shprehur gatishmëri që të paraqiten para organit kompetent për dhënien e deklaratës së trashëgimisë, në mënyrë që të mund të realizohet drejta e paditësve për bartjen e pronësisë në emër të tyre edhe në librat përkatës pronësor pranë komunës, me anë të kontratës.

Paditëset kanë theksuar se pushtetin faktik mbi këto paluajtshmëri e ka dhe se të njëjtat i shfrytëzon në mënyrë të rregullt dhe pa u penguar nga askush, përfshirë edhe të paditurit, dhe të drejtën e tyre për bartjen në emër të tyre të paluajtshmerive të cilat i kanë në posedim synojnë të realizoj përmes padisë për vërtetimin e pronësisë pasi që konsideron se kjo paluajtshmëri është pronë e tyre, të cilën e ka në posedim dhe shfrytëzim për më shumë se 20 vite prandaj konsiderojmë se i njëjtat e ka fituar të drejtën e pronësisë edhe mbi bazën e parashkrimit fitues.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Të paditurit H. Sh., S. Gj., K. Zh., D. Sh., F. Sh., E. Sh., Dh. Sh., R. Sh. 1 dhe R. Sh. 2, në përgjigje në padi të dhënë më datë 26.02.2024, të cilën e kanë paraqitur gjykatës të nënshkruar personalisht, kanë deklaruar një zëri se nuk e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit, të njëjtën kërkesë padi e pranoj si të bazuar mbi faktet e shënuara si në padi.

Kanë theksuar se: *“Prandaj me këtë shkresë konfirmojmë se këto parcela kadastrale të cekura si në padi janë në posedim paditëseve por që kalimi i pronësisë edhe në mënyrë legale në pronësi të paditëseve nuk ësh[të] bërë deri më tani për arsye se deri më tani nuk kemi mundur ta kryejmë procedurën e trashëgimisë ne si pasardhës të vetëm të të ndjerit E. F. Sh. andaj pranojmë që paluajtshmeritë kontestuese të kalojnë në emër të paditëseve Z. Sh. dhe R. Sh.”*

Gjithashtu kanë propozuar që gjykata të merr aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore dhe po ashtu kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës.

Gjykata në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Certifikata Pronësore me nr...., lëshuar nga Zyra Kadastrale, Komuna Kaçanik, vërteton se pasuria e paluajtshme objekt kontesti, evidentohet në emër të të ndjerit E. (F.) Sh.. Certifikata e vdekjes nr. ref. 7/... për E. Sh. , Certifikata e vdekjes nr. Ref. 7/... për N. Sh., Certifikata e vdekjes nr. Ref. 7/... për F. Sh., Dëshmi Vdekje, e datës 06.09.2023, Certifikata e vdekjes nr. Ref. 19... për Z. Sh., Certifikata e vdekjes nr. Ref. 19... për R. Sh., Certifikata e vdekjes nr. Ref. 19... për N. Sh., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për të paditurin A.V., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. E ..., për të paditurin D. Sh., Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. ..., për të paditurin F. Sh. , Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. ..., për të paditurin E. Sh. , Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. ..., për të paditurin Dh. Sh. , Ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile me nr. Ser. ..., për të paditurin R. Sh. 1 , Certifikate e lindjes me nr. Ser. L..., për të paditurin R. Sh. 2, vërtetohet dhe konstatohet se të paditurit, janë trashëgimtarët, e të ndjerit E. (F.) Sh., në emër të të cilit evidentohen këto prona, e që për arsyeje te pa njohura nuk e kane bere bartjen e pronësisë, kurse paditëset vazhdojnë që të ketë interes juridik për përcaktimin e statusit juridik të pasurisë së paluajtshme e që është në posedim të tyre, për këtë fakt nuk e kanë mohuar edhe të paditurit në bazë të përgjigjes në padi, me çka gjykata është bindur se nuk ka kontest pronësor në lidhje me këtë çështje.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve me anë të përgjigjes në padi vlerësoi se pohimi i të paditurve është bërë me vullnet të lirë të pa penguar, i nënshkruar nga të paditurit, njëherit konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon*

*pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)” – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe po ashtu sipas nenit 398 par.1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” (Aktgjykim pa seancë gjyqësore). Gjykata vendosi jashtë seancës lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.*

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi si në dispozitiv të Aktgjykimit, që shpenzimet ti përballoj secila pale konform nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEGA KAÇANIK**

C.nr. 2023:210134, me datë 03.04.2024

Gjyqtari:

Burhan Berisha

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.